

Rregullorja për pjesëmarrje të publikut në punën e Kuvendit

Tema: Vendimet e KK

Data: Korrik 08, 2004 - 05:52 AM

Në mënyrë që puna e Kuvendit Komunal dhe e Komiteteve të tij të jetë sa më transparente për publikun, Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka miratuar Rregulloren që e garanton këtë relacion të rëndësishëm të institucioneve me publikun. Rregullorja parashehë mbledhjet e hapura të kuvendit dhe komiteteve të tij, njoftimin publik për takimet, pjesëmarrjen e publikut në takime dhe të tjera.

Në bazë të dispozitave të kapitullit 3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e vet, të mbajtur më 30.06.2004 nxorri këtë

RR E G U L L O R E PËR ZBATIMIN E DISPOZITAVE TË STATUTIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR KONSULLTIM DHE PJESËMARRJE TË PUBLIKUT

Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Neni 1

1.1. Me këtë Rregullore përcaktohet zbatimi i dispozitave përkitazi me konsulltimin dhe pjesëmarrjen e publikut të parashtruara në Statutin e Komunës së Gjilanit dhe me rreg. nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, si dhe me qëllim të garantimit të të drejtave të qytetarëve që të informohen dhe të marrin pjesë në qeverinë e tyre.

Fushëveprimtaria

Neni 2

2.1. Kjo rregullore ka të bëjë me takimet e kuvendit dhe të komiteteve komunale të cilat janë të hapura për qytetarë, me njoftimin e qytetarëve përkitazi me takimet, me pjesëmarrjen gjatë takimeve të kuvendit dhe të komiteteve, si dhe me informacionet e qeverisë që duhet t' u vihen në dispozicion qytetarëve.

2.2. Rregulla dhe procedura tjera plotësuese mund të parashtrohen në rregullore të tjera.

Mbledhjet e hapura të kuvendit

dhe komiteteve të tij

Neni 3

3.1. Konform nenit 7 të Rreg. së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, të gjitha takimet e kuvendit dhe të komiteteve të tij janë të hapura për qytetarë, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e shtypit.

3.2. Në rast kur kuvendit ose ndonjë komitet vendos në pajtim me nenin 7.3, 7.4 ose 7.5 që ndonjë takim ta mbyll për qytetarë dhe media, ai duhet të paraqes njoftim publik si dhe të jep publikisht shpjegim lidhur me arsyen për një vendim të tillë. Ky njoftim publik duhet ti vihet në dispozicion publikut së paku tre (3) ditë para takimit të caktuar si dhe duhet të jetë konform dispozitave të parapara në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Njoftimi publik për takimet

Neni 4

4.1. Ashtu siç kërkohet me rregu. nr. 2000/45, njoftimin publik për takimet e kuvendit dhe komiteteve komunale duhet dhënë së paku shtatë (7) ditë pune para takimit, ose përjashtimisht tri (3) ditë në raste të jashtëzakonshme ndërsa njoftimi publik për " Takimet Publike " duhet dhënë së paku dy (2) javë paraprakisht.

Neni 5

5.1. Njoftimi publik, për qëllime të kësaj rregulloreje :

- a) do të thotë njoftimi me shkrim lidhur me vendin, datën, ndërsa kur bëhet fjala për mbledhjet, krahas rendit të ditës që i thekson çështjet që do të diskutohen, duhet bashkangjitur edhe kohën që do të kushtohet secilës pike të rendit, si dhe përshkrim të shkurtër por domethënës të pikave të rendit të ditës,
- b) lëshohet në mënyrë vijuese : duke e afishuar në ndërtesën e Kuvendit Komunal të Gjilanit, duke e emituar në radiostacione lokale dhe duke e postuar në faqen e Kuvendit Komunal të Gjilanit në internet.
- c) Përfshinë një proklamata që personat që nuk janë në gjendje të marrin pjesë në mbledhjen e paralajmëruar, mund të i parashtrorjnë Kuvendit Komunal të Gjilanit, deri në kohën kur të fillojnë punimet, komente me shkrim lidhur me temën e mbledhjes. Komentet në fjalë do të vihen në vëmendje personit ose personave që drejtojnë mbledhjet ose personave publik, si dhe emrin dhe adresën e personit ose personave të cilëve duhet të i dorëzohen ato komente me shkrim.

Neni 6

- 6.1. Përshkrimi i një pikeje të rendit të ditës është domethënës nëse është mjaft i qartë dhe konkret për të ia tërhequr vëmendjen një personi me intelekt dhe arsimim mesatar interesat e të cilit preken nga pika e tillë.
- 6.2. Në rast se pika e rendit të ditës nuk mund të shkruhen në tërsi në një faqe shkrimi, përshkrimi duhet të përmbajë informata lidhur me atë se ku mund të sigurojnë qytetarët informatat plotësuese përkitazi me pikat e rendit të ditës para mbajtjes së takimit.

Pjesmarrjet e publikut në takime
Mbledhjet publike
Neni 7

- 7.1. Ashtu siq parashihet në kapitullin III neni 21 të Statutit, procedurat që duhet ndjekur në takime publike i përcakton kryetari ose përfaqësuesi i tij ose saj i cili do të jetë kompetent për moslejimin e diskutimit të çështjeve që nuk përkojnë me përgjegjësitë ose kompetencat e komunës ose me drejtimin e punëve komunale, për kundërshtimin e dhënies së fjalës ose për të mos i dëgjuar folësit që paraqesin pikpamje të ngjashme ose të përsëritura dhe për të vendosur kufizime të përgjithëshme të kohës së lejuar për fjalime.

Mbledhjet e Kuvendit dhe të Komiteteve

Neni 8

- 8.1. Për çdo rend të ditës të takimit të kuvendit ose të komiteteve duhet të u ofrohet mundësia qytetarëve që të bëjnë vërejtje dhe të parashtrorjnë pyetje përkitazi me secilën pikë të rendit të ditës para se Kuvend të marrë çfarëdo vendimi lidhur me pikën përkatëse.
- 8.2. Një kufizim i arsyeshëm kohor do të caktohet për vërejtjet dhe pyetjet publike lidhur me çdo temë dhe kufizimi i tillë do të figurojë edhe në rend të ditës. Kufizimi i arsyeshëm kohor do të përcaktohet duke u mbështetur në natyrën rutinore ose kundërthënëse të temës, shkallën e interesimit të shprehur nga qytetarët për temën, ndikimin që vendimi do të ketë tek qytetarët si dhe ngutshmërinë kohore të çështjes për të u vendosur. Kohëzgjatja e përcaktuar për një rend të ditës, sido që të jetë, nuk mund të jetë më pak se 5 minuta dhe jo më shumë se 1 orë.
- 8.3. Qytetarët të cilët deshirojnë të drejtohen kuvendit ose komiteteve duhet të ia parashtrorjnë një kërkesë me shkrim kryetarit ose kryeshefit të ekzekutivit së paku 1 orë para takimit duke potencuar temën për të cilën personi në fjalë dëshjiron të flasë.
- 8.4. Kryetari ose përfaqësuesi i tij ose i saj i ftojnë qytetarët të cilët kanë parashtruar kërkesë me shkrim që të drejtohen kuvendit ose komiteteve si dhe të lejojnë fjalimet e tyre gjatë dhe deri në kohën e përcaktuar në rend të ditës.
- 8.5. Kryetari mund ta kufizojë kohën për çdo folës në 3 minuta. kryetari mund të mos ftojë apo të dëgjojë folësa ose mund të ua kufizojë kohën për të folur më pak se 3 minuta atyre folësve që paraqesin pikëpamje të përsëritura, atyre që deshirojnë të flasin për një temë që nuk figuron në rend të ditës apo që nuk është duke u shqyrtuar aktualisht nga kuvendi ose atyre që përmes fjalimit polemizues, shpifës ose iritues rrezikojnë që ta prishin takimin.
- 8.6. Kohëzgjatja e përcaktuar në rend të ditës për vërejtje dhe pyetje publike mund të zgjatet nga kryetari ose përfaqësuesi i tij ose saj. Përveç kësaj, ai ose ajo, sipas gjykimit të

tij ose të saj, mund t`ua japë drejtën për t`iu drejtuar kuvendit ose komiteteve individëve të cilët marrin pjesë në takim e që nuk kanë parashtruar kërkesë me shkrim në rast se qytetarët tregojnë intersimin e tyre për temën duke:

a) parashtruar kërkesa me shkrim për t`iu drejtuar kuvendit para mbajtjes së takimit se marrin pjesë në takimin e kuvendit në atë numër që nënkupton intersin e gjërë ose të ndjeshëm dhe/ose huti për temën

b) në rast se pikëpamjet e kundërta lidhur me temën nuk kanë pasur rast të dëgjohen në mënyrë të barabarët.

E drejta e publikut pët tu informuar

Neni 9

9.1. Në pajtim me Rregullorën nr. 2000/45 të UNMIK-ut neni 7, i cili përcakton të drejtën përcakton të drejtën e çdo personi që të shikojë dokumentet që mbahen nga komuna varësisht nga disa kufizime të caktuara, Qeveria Komunale do të nxjerrë rregulla dhe do të përcaktojë procedurën dhe mundësitë për pranimin dhe përpunimin e kërkesave për dokumente si dhe për shumëzimin dhe sigurimin e atyre dokumenteve me kohë.

9.2. Qeveria Komunale do ti përgjigjet kërkesës për shikim të dokumenteve me kohë dhe në mënyrë efikase dhe si do që të jetë Brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

9.3. Nëse ndonjë qytetari i refuzohet shikimi i ndonjë dokumenti në pajtim me Rregullorën nr. 2000/45 të UNMIK-ut, neni 7.3 ose për ndonjë arsye tjetër, personit që e ka bërë kërkesën duhet t`i paraqitet me shkrim arsyeja konkrete për refuzimin e tillë. Personi në fjalë ka të drejtë që të ushtroj ankesë kundër refuzimit tek Kryeshefi i Ekzekutivit i cili e miraton ose e hedh poshtë ankesën në fjalë Brenda 20 ditësh.

Neni 10

10.1. Nëse, përshkak të veçantisë së kërkesës ose të nevojës për konsulltim me një pale të tretë, Qeveria Komunale nuk mund ta sigurojë dokumentin e kërkuar Brenda 20 ditësh, ajo duhet ta njoftojë me shkrim palën e interesuar jo më vonë se 15 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës duke shpjeguar pamundësinë e përmbushjes së kërkesës për informim brenda afatit prej 20 ditësh, duke i potencuar arsyet ose shkaqet e vonës së gjithashtu dhe datën e sigurtë kur do të sigurohen dokumentet ose informatat.

10.2. Qeveria Komunale e publikon një shpallje duke potencuar të drejtën e qytetarëve që të shikojnë dhe/ose të sigurojnë kopje të dokumenteve si dhe procedurën që duhet ndjekur qytetari që kërkon dokumentet. Shpallja përfshinë vendet dhe personat të cilëve u paraqiten kërkesat, ditët dhe orët kur pranohen kërkesat, formularët eventuale që duhet plotësuar për paraqitjen e kërkesës, të dhënat e nevojshme për gjetjen e dokumenteve që kërkohen dhe afatet kohore gjatë të cilave do të kthehen përgjigjet. Publikimi, për qëllime të kësaj dispozite, nënkupton afishimin e informative në një vend të dukshëm për qytetarë në ndërtesën e Qeverisë Komunale të Gjilanit, në faqen e Qeverisë Komunale në internet dhe në mediat lokale.

Informacionet e Qeverisë Komunale në dispozicion për publikun

Neni 11

11.1. Qeveria Komunale, brenda 3 muajsh nga data kur kjo rregullore hyn në fuqi, duhet ta publikojë një shpallje duke shënuar departamentet, komisionet, sektoret dhe zyret e qeverisë, detyrat e tyre përkatëse, emrin e personit përgjegjës për punët e tyre, lokacionet, ditët dhe orarin e punës, terminet e caktuara gjatë të cilave qytetarët mund të kryejnë punë në institucionet komunale dhe merin dhe shenimet kontaktuese të personit të ngarkuar me nenin 6.3 për ofrimin e informative publike. Kjo shpallje duhet të plotësohet dhe të ripublikohet çdo 6 muaj. Publikimi, për qëllime të këtij neni, nënkupton afishimin e informative në një vend të dukshëm për qytetarë në ndërtesën e Qeverisë Komunale të Gjilanit, faqen e Qeverisë Komunale në internet dhe (ndonjë mënyrë tjetër për shpërndarjen dhe vënien në dispozicion të kësaj shpalljeje)

11.2. Çdo shef departamenti i Qeverisë Komunale në internet duhet ta ngarkojë një person ose disa persona të njohur me punët e departamentit të cilët do të jenë përgjegjës për ofrimin e informative me gojë dhe me shkrim me kërkesë të qytetarëve përkitazi me ecurinë e punës, planet, politikat dhe qendrimet e departamentit. Personi i ngarkuar asisoj duhet të

jetë i përgatitur që të ofrojë, me kërkesë, informata të caktuara gojore dhe me shkrim përkitazi me :

- a) rregullat, procedurat dhe mënyrat me anë të së cilave qytetarët mund të kryejnë punë në departament,
- b) politikat e përgjithëshme dhe rregullat ligjore me anë të cilave vepron drejtorati dhe
- c) shpjegimet e hollësishme të mënyrave të punës dhe të procedurave të këtij organi publik.

11.3. Qeveria Komunale duhet Brenda 3 muajve nga data kur kjo rregullore hyn në fuqi, ta ëubnllojë një deklaratë të të drejtave të qytetarëve të cilat parashihen në këtë rregullore: të drejtën për 14 ditë njoftim paraprak për takimet e Kuvendit dhe komisioneve, duke përfshirë edhe rendin e ditës si dhe një përshtkrim domëthënës të pikave të rendit të ditës, të drejtën për pjesmarrje dhe dëshmi në takimet e Kuvendit dhe të komisioneve varësisht nga rregullat procedurale në fuqi, të drejtën për qasje në dokumentet publike dhe të drejtën për qasje në informata përkitazi me ecurinë e punës, planet, politikat dhe qëndrimet e drejtorateve të ndryshme të Qeverisë Komunale.

Neni 12

12.1. Qeveria Komunale e Gjilanit, në një faqe në rrjetin e internetit ose në ndonjë lokacion tjetër të qasshëm lehtë në internet, do të siguroj informacione të cilat kërkohen që t`i vëhen në dispozicion publikut, duke përfshirë edhe njoftimet me kohë për takimet e Kuvendit dhe të komiteteve, si dhe rendet e ditës, procesverbalet nga takimet e Kuvendit dhe të komiteteve, informacionet e kërkuara në pajtim me nenin 6 të kësaj rregulloreje si dhe kopjet e statututit komunal të Gjilanit, të rregullorës së punës dhe të gjitha rregulloreve të tjera të miratuara nga kuvendi. Çdo departament obligohet që t`i vëjë në dispozicion publikut, perms faqes së vet në inernet sa më shumë informacione dhe sa më shumë dokumente që është e mundur lidhur me veprimtaritë e tij dhe shërbimin që bënë ai ndaj qytetarëve. Çdo departament ka për detyrë që faqja në internet të rishikohet për nga saktësia dhe të azhurohet ku është në pyetje fushëveprimtaria e vetë së paku një herë në javë.

Neni 13

13.1. Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT KRYETARI I KK
/Lutfi Haziri/